

L I G J
Nr.7903, datë 8.3.1995

**PËR DEKLARIMIN E PASURIVE TË TË ZGJEDHURVE DHE TË DISA DREJTUESVE E
PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT PUBLIK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit Popullor, Kryetari i Këshillit të Ministrave, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe personat e barazuar me ta si dhe zëvendësit e tyre, drejtorët e ministrave dhe punonjësit e Kuvendit Popullor, të Presidencës dhe të Këshillit të Ministrave të këtyre niveleve, gjyqtarët, hetuesit dhe prokurorët e të gjitha niveleve, drejtuesit e Forcave të Armatosura, të SHIK-ut, SHIR-it, SHIU-t dhe të strukturave të mëparshme të këtyre lloj shërbimeve, prefektët, anëtarët e këshillave të rretheve, kryetarët e bashkive, anëtarët e këshillave bashkiake dhe kryetarët e komunave, kur këta persona kanë ose kanë pasur funksione të tilla që nga 1 janari 1991, brenda tre muajve nga shpallja e këtij ligji, duhet të deklarojnë për vete dhe familjen e tyre:

1. Pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, si dhe burimin e tyre.
2. Aksionet dhe letrat me vlerë në zotërim të tyre.
3. Shumat në të holla ose sende me vlerë mbi 1 milionë lekë dhe pasuri të luajtshme të regjistruara në administratën shtetërore, si dhe burimin e tyre.
4. Funksionet që kanë ose kanë pasur në shoqëritë tregtare dhe pjesa e kapitalit të tyre në to.
5. Dëshmi zyrtare të të ardhurave që i janë nënshtruar tatimit mbi të ardhurat personale të vitit të fundit, që prej hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 2

Personat e përmendur në nenin 1 të këtij ligji në tremujorin e parë të çdo viti duhet të deklarojnë ndryshimet që kanë pësuar pasuritë e tyre gjatë vitit kalendarik të mëparshëm ndaj atyre të deklaruara një vit më parë. Detyrimi për deklarimin e pasurive të këtyre personave shtrihet edhe në pesë vitet vijuese pas lënies së funksionit shtetëror.

Neni 3

Presidenti i Republikës, deputetët e Kuvendit Popullor, Kryetari i Këshillit të Ministrave, anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe personat e barazuar me ta, si dhe zëvendësit e tyre, i depozitojnë deklaratat e mësipërme në Kuvendin Popullor, kurse gjithë personat e tjerë në organet tatimore të vendbanimit të tyre.

Neni 4

Dispozitat e mësipërme zbatohen edhe për:

1. Drejtuesit e institucioneve shtetërore, duke përfshirë edhe ato me veprimtari ekonomike, që emërohen, propozohen ose miratohen nga Kuvendi Popullor, Presidenti i Republikës, Kryetari i Këshillit të Ministrave, Këshilli i Ministrave a nga ministra e persona të barazuar me ta.
2. Punonjësit e doganave, tatimeve, të Shërbimit të Kontrollit të Shtetit, oficerët e Ushtrisë dhe të Policisë së Rendit, të Policisë Financiare, punonjësit e Agjensisë Kombëtare, degëve të saj, bordeve dhe komisioneve e nënkomisioneve të privatizimit, likuidatorëve të ndërmarrjeve dhe ARN,

kryetarët e anëtarët e komisioneve të kthimit të pronave, drejtuesit e KRT në rrethe dhe nëpunësit e kreditit në bankat e shtetit dhe në ato ku shteti është pjesëmarrës.

3. Drejtorët dhe anëtarët e këshillave drejtuese të ndërmarrjeve dhe bankave shtetërore.

4. Drejtuesit dhe administratorët e shoqërive në kapitalin e të cilave shteti merr pjesë me mbi 20 për qind.

5. Drejtuesit dhe administratorët e shoqërive a institucioneve private, ose institucioneve shtetërore, në funksionimin e të cilave shteti merr pjesë me më shumë se 50 për qind të shpenzimeve të paraqitura në bilancin e tyre.

6. Drejtuesit e bashkësive ekonomike, drejtorive të përgjithshme apo institucioneve shtetërore të pavarura.

Neni 5

Verifikimi i deklaratave të mësipërme bëhet nga organet përkatëse të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 6

Shërbimi i Kontrollit të Shtetit mbikqyr organet e ngarkuara nga Këshilli i Ministrave për verifikimin e këtyre deklaratave dhe, kur gjen pasaktësi e shkelje, dënon për kundërvajtje administrative personat përgjegjës me gjobë në masën e përcaktuar në paragrafin e dytë të nenit 8 të këtij ligji.

Neni 7

Shkeljet e neneve 1 dhe 2 të këtij ligji dhe deklaratat për Presidentin e Republikës, deputetët e Kuvendit Popullor, Kryetarin e Këshillit të Ministrave, për anëtarët e Këshillit të Ministrave, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Kasacionit, punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit dhe personat e barazuar me ta shqyrtohen e verifikohen nga një komision i përbashkët i përbërë prej 9 anëtarësh, që zgjedh nga gjiri i vet kryetarin. Mandati i tyre është 1 vit. Kuvendi Popullor cakton katër anëtarë, Këshilli i Ministrave dhe Gjykata e Kasacionit caktojnë nga dy anëtarë secili dhe një anëtar caktohet nga Shërbimi i Kontrollit të Shtetit.

Për shkeljet e vërejtura ky komision ka të drejtë të dënojë për kundërvajtje administrative me gjobë në masën e përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji. Kundër vendimit të dënimit dhe verifikimit mund të bëhet ankim, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së vendimit, në Gjykatën e Kasacionit.

Neni 8

Shkeljet e rregullave të parashikuara në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji nga persona të tjerë me përjashtim të atyre të përmendur në nenin 7, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen:

- Për mosparaqitjen në kohën e duhur pa shkaqe të arësyeshme të deklaratës me gjobë në masën 1 000 deri në 50 000 lekë nga inspektorët e tatimeve të rrethit.

- Për deklarata të rreme me dashje me gjobë në masën 500 000 deri në 1 000 000 lekë për çdo rast nga kryetari i degës së policisë financiare, si dhe me heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit deri në 5 vjet.

Kundër vendimeve të dënimit mund të bëhet ankim në gjykatën e rrethit brenda 10 ditëve nga dita e shpalljes së vendimit.

Kur shkelja përbën vepër penale, bëhet kallëzim në organet e prokurorisë.

Neni 9

Organet e ngarkuara me gjykimin e kundërvajtjeve administrative sipas këtij ligji, krahas dënimit me gjobë vendosin edhe për pasurinë e fituar nga burime të paligjshme prej personave të përcaktuar në nenet 1 dhe 4 të këtij ligji. Kjo pasuri konfiskohet nga policia financiare dhe kalon në dobi të shtetit.

Neni 10

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet përkatëse për zbatimin e këtij ligji.

Neni 11

Dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 12

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr. 1042, datë 20.3.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha